



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN KRYESISHT TË SEKRETARIT TË KZAZ NR. 46, LIRIMIN DHE EMËRIMIN E ANËTARIT TË KZAZ NR. 38, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 28.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Lirimin dhe emërimin kryesisht të sekretarit të KZAZ nr. 46, lirimin dhe emërimin e anëtarit të KZAZ 38, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 29, pika 5, neni 30, neni 31, neni 32 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Me shkresën nr. 4947 prot., datë 28.05.2019, sekretarja e emëruar kryesisht nga KQZ për plotësim të vakancës në KZAZ nr. 46, zj. Elona Lleshi, ka deklaruar dorëheqjen nga detyra për arsye objektive.

Në listën e shtetasve miratuar nga KQZ me vendimin nr. 140, datë 9.04.2019, pas plotësimit të vakancave të KZAZ me emërimet kryesisht nga KQZ:

- rezultojnë të pa emëruar 231 shtetas,
- nuk rezulton shtetas i paemëruar me arsim juridik dhe vendbanim në Bashkinë Cërrik.



Nr. 698 i Vendimit Data 28.05.2019 e Vendimit Ora 19:00 e Vendimit

Për lirimin dhe emërimin kryesisht të sekretarit të KZAZ nr. 46, lirimin dhe emërimin e anëtarit të KZAZ nr. 38, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

Në shqyrtim të kërkesave të shtetasve në përgjigje të njoftimit publik të KQZ-së, por që për shkak të paraqitjes në tejkalim të afatit të përcaktuar, nuk janë bërë pjesë e lidhjes 1 të vendimit nr. 140, datë 09.04.2019, rezulton se:

- Zj. Resina Artan Jaupaj, shtetase me vendbanim në Bashkinë Cërrrik,

ka paraqitur kërkesë për t'u emëruar kryesisht sekretare e KZAZ-së, plotëson kushtet e përcaktuara në nenet 30 dhe 31 të Kodit Zgjedhor dhe i propozohet KQZ-së për ta emëruar kryesisht sekretare e KZAZ nr. 46.

Partia Socialiste e Shqipërisë, me shkresën nr. 4927 prot., datë 28.05.2019, bazuar në nenin 32, pika 2, germa "d", të Kodit Zgjedhor, kërkon lirim të anëtares të KZAZ nr. 38, Bashkia Tiranë, zj. Yllka Qejvani dhe emërim në këtë detyrë të z. Astrit Esat Zekaj.

Kërkesa dhe propozimi i paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë, janë në përputhje me kërkesat e nenit 30, 31 dhe 32 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 29, pika 5, nenin 30, nenin 31, nenin 32, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Të lirojnë nga detyra sekretaren e KZAZ-së nr.46, zj. Elona Lleshi, Bashkia Cërrrik dhe anëtares e KZAZ-së nr. 38, zj. Yllka Qejvani, Bashkia Tiranë.
2. Të emërojnë kryesisht sekretarin e KZAZ-së nr.46, zj. Resina Jaupaj, Bashkia Cërrrik dhe anëtarin e KZAZ nr. 38, z. Astrit Zekaj, Bashkia Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 698 i Vendimit Data 28.05.2019 e Vendimit Ora 19:00 e Vendimit

Për lirim dhe emërimin kryesisht të sekretarit të KZAZ nr. 46, lirim dhe emërimin e anëtarit të KZAZ nr. 38, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.